UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 638, datë 17.1.2020

MBI KONTROLLIN PËR GATISHMËRINË TEKNIKE NË RRUGË TË MJETEVE TREGTARE[1]

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 12, 78 dhe 224, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të neneve 21 dhe 233, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Rregullorja e zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ministri i Brendshëm

UDHËZOJNË:

KAPITULLI I
QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1
Qëllimi

Me qëllim përmirësimin e sigurisë rrugore dhe pakësimin e ndotjes së ambientit, ky udhëzim përcakton kërkesat minimale të procedurave të inspektimit teknik në rrugë, në lidhje me përshtatshmërinë teknike të mjeteve rrugore të transportit të mallrave dhe njerëzve, që qarkullojnë në territorin e Shqipërisë.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky udhëzim do të zbatohet për mjetet rrugore me motor, me një shpejtësi të projektuar më shumë se 25 km/orë, të kategorive të mëposhtme:

a) mjete të projektuara dhe të ndërtuara, kryesisht për transportin e njerëzve dhe të bagazheve të tyre, me më shumë se nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtuesit të mjetit – kategoritë e mjeteve M2 dhe M3;

b) mjete të projektuara dhe të ndërtuara kryesisht për transportin e mallrave dhe që kanë një peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë – kategoritë e mjeteve N2 dhe N3;

c) rimorkiot e projektuara dhe të ndërtuara për transportin e mallrave ose të njerëzve, si dhe për akomodimin e njerëzve, me një masë maksimale më të madhe se 3.5 tonë – kategoritë e mjeteve O3 dhe O4;

d) traktorë me rrota të kategorisë T5, përdorimi i të cilëve bëhet kryesisht në rrugë publike, për qëllime të transportit rrugor të mallrave, me një shpejtësi maksimale të projektuar më shumë se 40 km/orë.

Neni 3
Përkufizime

Përkufizimet e mëposhtme zbatohen vetëm për qëllimin e këtij udhëzimi:

1. "Mjet" nënkupton çdo mjet motorik që nuk është hekurudhor ose rimorkio e tij.

---

[1] Udhëzimi synon përputhshmërinë të plotë me Direktivën nr. Celex 32014L0047, 2014/47/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e prill 2014 mbi kontrollin teknik në anë të rruges për gatishmërinë teknike të mjeteve tregtare që qarkullojnë në Bashkimin Evropian dhe që shfuqizon Direktivën 2000/30/EC

2. “Mjet motorik” nënkupton çdo mjet me rrota i drejtuar me energji të vetën me shpejtësi maksimale të projektuar më shumë se 25 km/orë.

3. “Rimorkio” nënkupton çdo mjet jovetëlëvizës me rrota, i cili është projektuar dhe ndërtuar për t’u tërhequr nga mjeti motorik.

4. “Gjysmërimorkio” nënkupton çdo rimorkio të projektuar për t’u bashkuar me një mjet motorik, në mënyrë të tillë që një pjesë e tij mbështetet në mjetin motorik dhe një pjesë e konsiderueshme e peshës së tij dhe e peshës së ngarkesës së tij bartet nga mjeti motorik.

5. “Ngarkesë” nënkupton të gjitha mallrat që normalisht do të vendosen brenda ose në pjesën e mjetit të projektuar, për të mbajtur një ngarkesë dhe që nuk janë të fiksuar në mënyrë të përhershme me mjetin, duke përfshirë objektet brenda transportuesve të ngarkesave, siç janë arkat, trupat e shkëmbyeshëm ose kontejnerët.

6. “Mjet tregtar” nënkupton një mjet motorik dhe rimorkion e tij ose gjysmërimorkion i përdorur kryesisht për transportin e mallrave ose të udhëtarëve për qëllime tregtare, si p.sh., për transport për të tretë ose për nevojat e veta ose për qëllime të tjera profesionale.

7. “Mjet i regjistruar” nënkupton një mjet i cili është i regjistruar ose vënë në shërbim në Shqipëri.

8. “Mbajtës i certifikatës së pronësisë” nënkupton personin juridik ose fizik në emër të të cilit është regjistruar mjeti.

9. “Ndërmarrje” nënkupton një ndërmarrje, siç përcaktohet në nenin 3, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, i përditësuar.

10. “Kontroll teknik në rrugë” nënkupton një inspektim teknik të papritur të përshtatshmërisë teknike të një mjeti tregtar të kryer nga autoriteti kompetent i përcaktuar nga legjislacioni përkatës ose nën varësinë e tyre të drejtpërdrejtë.

11. “Rrugë publike” nënkupton një rrugë që është në shërbim të përgjithshëm publik, siç është rruga lokale, rajonale ose kombëtare, rruga interurbane kryesore apo autostrada.

12. “Kontroll teknik” nënkupton një kontroll në përputhje me nenin 79 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

13. “Certifikatë e kontrollit teknik” nënkupton raportin e kontrollit teknik të lëshuar nga autoriteti kompetent ose një qendër kontrolli që përmban rezultatin e kontrollit teknik.

14. “Autoritet kompetent” nënkupton një autoritet ose organ publik të përcaktuar nga legjislacioni me përgjegjësinë për administrimin e sistemit të kontrolleve teknike në rrugë, duke përfshirë, kur është e nevojshme, kryerjen e kontrolleve të tilla.

15. “Inspektor” nënkupton një person të autorizuar nga autoriteti kompetent për të kryer kontrolle teknike fillestare dhe/ose më të detajuara në rrugë.

16. “Defekte” nënkupton defektet teknike dhe raste të tjera mospërputhjesh të gjetura gjatë një kontrolli teknik në rrugë.

17. “Kontroll i bashkërenduar në rrugë” nënkupton një kontroll teknik në rrugë që ndërmerret bashkërisht nga autoritetet kompetente të dy ose më shumë shteteve.

18. “Operator” nënkupton një person fizik ose juridik që drejton mjetin si pronar ose i autorizuar për të drejtuar mjetin nga pronari i tij.

19. “Njësi e lëvizshme kontrolli” nënkupton një sistem të transportueshëm të pajisjeve të kontrollit, të nevojshme për kryerjen e kontrolleve më të detajuara teknike në rrugë, me personel nga inspektorët kompetentë për të kryer kontrolle më të detajuara në rrugë.

20. “Vend i caktuar për kontrollin në rrugë” nënkupton një zonë fikse për kryerjen e kontrolleve teknike fillestare dhe/ose më të detajuara në rrugë, të cilat, gjithashtu, mund të pajisen me pajisje kontrolli të instaluara në mënyrë të përhershme.

KAPITULLI II
SISTEMI I KONTROLLIT TEKNIK NË RRUGË DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Neni 4

Sistemi i kontrollit teknik në rrugë

Sistemi i kontrollit teknik në rrugë do të përfshijë kontrollet teknike fillestare në rrugë, siç referohet në nenin 10, pika 1 dhe kontrolle teknike më të detajuara në rrugë, siç referohet në nenin 10, pika 2.

Neni 5

Përqindja e mjeteve që duhet të kontrollohen

1. Për mjetet e përmendura në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 2, numri i përgjithshëm i kontrolleve teknike fillestare në rrugë, për çdo vit kalendarik, të jetë të paktën 5% e numrit të përgjithshëm të mjeteve të regjistruara.

2. Informacioni për mjetet e kontrolluara i dërgohet ministrisë përgjegjëse për transportin.

Neni 6

Sistemi i vlerësimit të riskut

Për mjetet e përmendura në shkronjat "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 2, autoriteti kompetent duhet të garantojë që informacioni, në lidhje me numrin dhe seriozitetin e mangësive të përcaktuara në aneksin II dhe aty ku është e zbatueshme, në aneksin III, i krijuar për mjetet e operuara nga ndërmarrje të veçanta të vihet në sistemin e vlerësimit të rrezikut. Për cilësimin e një profili të rrezikut për një ndërmarrje, autoriteti kompetent mund të përdorë kriteret e paraqitura në aneksin I. Ky informacion do të përdoret për të kontrolluar ndërmarrjet, me vlerësim të lartë të rrezikut, më nga afër dhe më shpesh. Sistemi i vlerësimit të rrezikut do të operohet nga autoriteti kompetent.

Për qëllimin e zbatimit të paragrafit të parë, autoriteti kompetent përdor informacionin e marrë nga vendet e tjera, sipas nenit 18, pika 1.

Neni 7

Përgjegjësitë

1. Certifikata e kontrollit teknik që korrespondon me kontrollin më të fundit periodik teknik ose një kopje e vërtetuar, ose, në rastin e një certifikate të kontrollit teknik të prodhuar në mënyrë elektronike, një kopje e vërtetuar ose origjinale e shtypur të kësaj certifikate dhe raporti më i fundit i kontrollit teknik në rrugë, të mbahet në bordin e mjetit kur ato disponohen. Autoriteti kompetent mund të pranojë dëshmi elektronike të kontrolleve të tilla, kur informacioni përkatës është i arritshëm.

2. Ndërmarrjet dhe drejtuesit e mjeteve që i nënshtrohen një kontrolli teknik në rrugë të bashkëpunojnë me inspektorët dhe të sigurojnë akses në mjet, pjesët e tij dhe në të gjithë dokumentacionin përkatës për qëllimet e kontrollit.

3. Ndërmarrjet janë përgjegjëse për mbajtjen e mjeteve të tyre në një gjendje të sigurt dhe të përshtatshme teknike, pa paragjykuar përgjegjësitë e drejtuesve të këtyre mjeteve.

Neni 8

Inspektorët

1. Gjatë zgjedhjes së një mjeti për një kontroll teknik në rrugë dhe gjatë kryerjes së këtij kontrolli, inspektorët duhet të shmangin çdo diskriminim në bazë të kombësisë së drejtuesit ose të vendit të regjistrimit ose të vënies në shërbim të mjetit.

2. Gjatë kryerjes së kontrollit teknik në rrugë, inspektori duhet të jetë i lirë nga çdo konflikt interesi që mund të ketë ndikim në paanësinë dhe objektivitetin e vendimit të tij.

3. Shpërblimi i inspektorëve nuk lidhet drejtpërdrejt me rezultatet e kontrolleve teknike fillestare ose më të detajuara në rrugë.

4. Kontrollet teknike më të detajuara në rrugë, në objektet e caktuara të kontrollit me përdorimin e njësive të lëvizshme të kontrollit, të kryhen nga inspektorët që përmbushin kërkesat minimale të kompetencës dhe trajnimit të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

KAPITULLI III
PROCEDURAT E KONTROLLIT TEKNIK

Neni 9
Përzgjedhja e mjeteve për kontroll teknik fillestar në rrugë

Kur identifikohen mjete që do t'i nënshtrohen një kontrolli teknik fillestar në rrugë, inspektorët mund të përzgjedhin si prioritet, mjetet e operuara nga ndërmarrjet me profil të lartë rreziku, siç referohet në nenin 6. Mjetet, gjithashtu mund të përzgjidhen rastësisht për kontroll ose kur ekziston dyshimi se mjeti paraqet rrezik për sigurinë rrugore ose për mjedisin.

Neni 10
Përmbajtja dhe metoda e kontrolleve teknike në rrugë

1. Autoriteti kompetent garanton që mjetet e përzgjedhura në përputhje me nenin 9, i nënshtrohen një inspektimi teknik fillestar në rrugë.

Në çdo kontroll teknik fillestar në rrugë të një mjeti, inspektori:

a) do të kontrollojë certifikatën më të fundit të kontrollit teknik dhe raportin e kontrollit teknik në rrugë, kjo e fundit kur është në dispozicion, të mbajtura në bord ose dëshmi elektronike të tyre në përputhje me nenin 7, pika 1;

b) do të kryejë një vlerësim vizual të gjendjes teknike të mjetit;

c) mund të kryejë një vlerësim vizual të sigurimit të ngarkesës së mjetit, në përputhje me nenin 13;

d) mund të kryejë kontrolle teknike me çfarëdo metode që konsiderohet e përshtatshme. Kontrollet e tilla teknike mund të kryhen në mënyrë që të arsyetohet një vendim për t'i kryer mjetit një kontroll më të detajuar në rrugë ose që të kërkohet që defektet të korrigjohen pa vonesë në përputhje me nenin 14, pika 1.

Inspektori verifikon nëse ndonjë mangësi e treguar në raportin e mëparshëm të kontrollit teknik në rrugë është korrigjuar.

2. Në bazë të rezultatit të kontrollit teknik fillestar, inspektori vendos nëse mjeti ose rimorkioja e tij duhet t'i nënshtrohen një kontrolli teknik më të detajuar.

3. Një kontroll teknik më i detajuar në rrugë do të mbulojë ato elemente të renditura në aneksin II, që konsiderohen të nevojshme dhe të bazuara, duke marrë parasysh në veçanti sigurinë e frenave, gomave, rrotave, shasisë dhe ndikimit të zhurmave në mjedis dhe metodat e rekomanduara të zbatueshme për kontrollin e këtyre elementeve.

4. Kur certifikata e kontrollit teknik ose raporti i kontrollit teknik në rrugë tregon se kontrolli i njërit prej elementeve të listuara në aneksin II është kryer gjatë tre muajve të mëparshëm, inspektori nuk e kontrollon atë element, përveç rastit kur një kontroll i tillë justifikohet për shkak të një defekti të dukshëm.

Neni 11

Objektet ku kryhet kontrolli teknik

1. Një kontroll teknik më i detajuar në rrugë, të kryhet duke përdorur njësi të lëvizshme kontrolli ose një objekt i posaçëm kontrolli në rrugë ose në një qendër kontrolli teknik, kjo e fundit, siç referohet në legjislacionin përkatës.

2. Kur një kontroll më i detajuar duhet të kryhet në një qendër kontrolli ose në një objekt të posaçëm kontrolli në rrugë, ai duhet të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur në një nga qendrat ose objektet praktikisht më të afërta.

3. Njësitë e lëvizshme të kontrollit dhe objektet e posaçme të kontrollit në rrugë duhet të përfshijnë pajisjet e përshtatshme për kryerjen e një kontrolli teknik më të detajuar në rrugë, duke përfshirë pajisjet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen e frenave dhe efikasitetin e frenave, drejtimin, suspensionin dhe ndikimin e zhurmave në mjedis të mjetit sipas kërkesave. Aty ku njësitë e lëvizshme të kontrollit ose objektet e posaçme të kontrollit në rrugë nuk përfshijnë pajisjet e kërkuara për të kontrolluar një element të treguar në një kontroll fillestar, mjeti duhet të drejtohet në një qendër kontrolli ose në një objekt ku mund të kryhet një kontroll më i detajuar i atij elementi.

Neni 12

Vlerësimi i defekteve

1. Për çdo element që duhet të kontrollohet, aneksi II jep një listë të defekteve të mundshme dhe shkallën e seriozitetit të tyre për t'u përdorur gjatë kontrolleve teknike në rrugë.

2. Mangësitë e gjetura gjatë kontrolleve teknike në rrugë të mjeteve duhet të kategorizohen në njërin nga grupet e mëposhtme:

a) defekte të vogla që nuk kanë efekt të rëndësishëm në sigurinë e mjetit ose ndikim në mjedis, dhe mospërputhje të tjera të vogla;

b) defekte të mëdha, që mund të dëmtojnë sigurinë e mjetit ose të kenë ndikim në mjedis ose të rrezikojnë përdoruesit e tjerë të rrugës ose mospërputhje të tjera më të rëndësishme;

c) defekte të rrezikshme, që përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë në rrugë ose që kanë ndikim në mjedis.

3. Një mjet që ka defekte që kategorizohen në më shumë se një nga grupet e defekteve të përmendura në paragrafin 2, do të klasifikohet në grupin që korrespondon me defektet më serioze. Një mjet që tregon disa defekte brenda të njëjtave fusha kontrolli, siç është përcaktuar në objektin e kontrollit teknik në rrugë, të përmendur në pikën 1 të aneksit II, mund të klasifikohet në grupin tjetër me defekte më serioze, nëse konsiderohet se efekti i kombinuar i këtyre defekteve rezulton në një rrezik më të lartë për sigurinë në rrugë.

Neni 13

Kontrolli i sigurimit të ngarkesave

1. Gjatë një kontrolli në rrugë, një mjet mund t'i nënshtrohet një kontrolli të sigurimit të ngarkesës së tij, në përputhje me aneksin III, me qëllim të garantohet që ngarkesa është siguruar në mënyrë që të mos pengojë në drejtimin e sigurt ose që të paraqesë kërcënim për jetën, shëndetin, pronën ose mjedisin. Kontrollet mund të kryhen për të verifikuar që gjatë të gjitha llojeve të operimit të mjetit, duke përfshirë situatat emergjente ose manovrat e ngjitjes në të përpjetë:

- ngarkesat ndryshojnë vetëm minimalisht pozicionin e tyre, në lidhje me njëra-tjetrën, kundrejt mureve ose sipërfaqeve të mjetit; dhe

- ngarkesat nuk mund të lënë hapësirën e ngarkesës ose të lëvizin jashtë sipërfaqes së ngarkesës.

2. Pa cenuar kërkesat e zbatueshme për transportin e kategorive të caktuara të mallrave, të tilla si ato të përfshira në Marrëveshjen Evropiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR) dhe legjislacioni tjetër për mallrat e rrezikshme, sigurimi i ngarkesave dhe kontrolli i sigurimit të ngarkesës mund të kryhet në përputhje me parimet dhe, sipas rastit, standardeve të përcaktuara në seksionin I, të aneksit III. Mund të përdoret versioni i fundit i standardeve të përcaktuara në pikën 5, të seksionit I, të aneksit III.

3. Procedurat për t'u ndjekur të përmendura në nenin 14 mund të zbatohen edhe në rast të defekteve të mëdha ose të rrezikshme që lidhen me sigurimin e ngarkesave.

4. Personeli i përfshirë në kontrollin e sigurimit të ngarkesës të trajnohet në mënyrë adekuate për këtë qëllim.

Neni 14

Hapat për t'u ndjekur në rast të defekteve të mëdha ose të rrezikshme

1. Pa paragjykuar pikën 3 të këtij neni, çdo defekt i madh ose i rrezikshëm i zbuluar nga një kontroll fillestar ose më i detajuar, të korrigjohet përpara se mjeti të përdoret më tej në rrugë publike.

2. Inspektori mund të vendosë që mjeti t'i nënshtrohet një kontrolli teknik të plotë brenda një afati të përcaktuar kohor nëse është regjistruar në Shqipëri. Nëse mjeti është i regjistruar në një shtet tjetër, autoriteti kompetent mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të shtetit tjetër, nëpërmjet pikave të kontaktit të përmendura në nenin 17, të kryejë një kontroll të ri teknik të mjetit, sipas procedurës të përcaktuar në nenin 18, pika 2. Kur defekte të mëdha ose të rrezikshme gjenden në një mjet të regjistruar jashtë Bashkimit Evropian, autoriteti kompetent mund të vendosë të informojë autoritetin kompetent të vendit të regjistrimit të mjetit.

3. Në rast të ndonjë defekti që kërkon korrigjim të shpejtë ose të menjëhershëm për shkak të ndonjë rreziku të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndaj sigurisë rrugore, autoriteti kompetent duhet të garantojë që përdorimi i mjetit në fjalë të kufizohet ose të ndalohet deri sa këto defekte të jenë riparuar. Përdorimi i një mjeti të tillë mund të lejohet, me qëllim që të arrijë në një nga serviset e riparimit më të afërta ku këto defekte mund të riparohen, me kusht që defektet e rrezikshme në fjalë të jenë rregulluar në atë mënyrë, që të lejojë atë të arrijë në servis dhe se nuk ka rrezik të menjëhershëm për sigurinë e pasagjerëve të tij apo përdoruesve të tjerë të rrugës. Në rast të defekteve që nuk kërkojnë riparim të menjëhershëm, autoriteti kompetent mund të vendosë mbi kushtet dhe afatin e arsyeshëm kohor, sipas të cilit mjeti mund të përdoret përpara se defektet të riparohen.

Kur mjeti nuk mund të rregullohet në mënyrë të tillë që ta lejojë atë të arrijë në servis, mjeti mund të drejtohet në një vend të mundshëm ku mund të riparohet.

Neni 15

Masat administrative të kontrollit teknik në rrugë

Kur janë gjetur defekte pas një kontrolli më të detajuar, zbatohen nenet 78, 162 dhe 165 të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Raporti i kontrollit dhe bazat e të dhënave mbi kontrollet teknike në rrugë

1. Për çdo kontroll teknik fillestar të kryer në rrugë, mblidhet informacioni i mëposhtëm nga autoriteti kompetent:

a) vendi i regjistrimit të mjetit;

b) kategoria e mjetit;

c) rezultati i kontrollit teknik fillestar në rrugë.

2. Me përfundimin e një kontrolli më të detajuar, inspektori harton një raport, në përputhje me aneksin IV. Autoriteti kompetent i jep drejtuesit të mjetit një kopje të raportit të kontrollit.

3. Inspektori do t'i komunikojë autoritetit kompetent rezultatet e kontrollit teknik më të detajuar në rrugë, brenda një kohe të arsyeshme pas këtij kontrolli. Autoriteti kompetent do ta mbajë informacionin, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave, për jo më pak se 36 muaj nga data e marrjes së tij.

KAPITULLI IV
BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 17
Përcaktimi i një pike kontakti

1. Autoriteti kompetent cakton një pikë kontakti, e cila:

- siguron koordinimin me pikat e kontaktit të përcaktuara nga shtetet e tjera, për sa u përket veprimeve të ndërmarra sipas nenit 18;

- i përcjell të dhënat e përmendura në nenin 20, Komisionit Evropian, në bazë të statusit të Shqipërisë;

- siguron, kur është e përshtatshme, çdo shkëmbim tjetër informacioni dhe dhënien e ndihmës për pikat e kontaktit të shteteve të tjera.

2. Shqipëria i përcjell Komisionit emrat dhe detajet e pikës kombëtare të kontaktit dhe e informon pa vonesë për çdo ndryshim të saj dhe i kërkon Komisionit Evropian pikat e kontaktit të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Neni 18
Bashkëpunimi me shtetet e tjera

1. Në rastet kur defektet e mëdha ose të rrezikshme, ose defektet që rezultojnë në kufizimin ose në ndalimin e përdorimit të mjetit, gjenden në një mjet që nuk është i regjistruar në Shqipëri, pika e kontaktit njofton rezultatet e kontrollit te pika e kontaktit të shtetit tjetër të regjistrimit të mjetit. Ky njoftim duhet të përmbajë elementet e raportit të kontrollit teknik në rrugë, siç është paraqitur në aneksin IV dhe do të komunikohet preferimisht nëpërmjet regjistrit elektronik kombëtar të ndërmarrjeve të transportit rrugor të përcaktuar në legjislacionin përkatës.

2. Në rastet kur janë gjetur defekte të mëdha ose të rrezikshme në një mjet, pika e kontaktit e autoritetit kompetent të Shqipërisë mund t'i kërkojë autoritetit kompetent të shtetit në të cilin mjeti është regjistruar, nëpërmjet pikës përkatëse të kontaktit të këtij shteti, që të ndërmarrë veprimet e duhura përcjellëse, të tilla si dërgimi i mjetit për një kontroll tjetër teknik, siç parashikohet në nenin 14.

Neni 19
Kontrolle teknike në rrugë të bashkërenduara

Në baza vjetore, autoriteti kompetent mund të ndërmarrë rregullisht aktivitete të përbashkëta kontrolli në rrugë me shtete të tjera. Të tilla kontrolle mund të kombinohen me ato të parashikuara për kontrollin e zbatimit të legjislacionit social të orëve të punës në transportin rrugor.

Neni 20
Komunikimi i informacionit për Komisionin Evropian

1. Autoriteti kompetent, në bazë të statusit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, do t'i komunikojë Komisionit Evropian me anë të mjeteve elektronike, të dhënat e mbledhura në lidhje me dy vitet e kaluara, në lidhje me mjetet e kontrolluara në territorin e saj. Këto të dhëna duhet të tregojnë:

a) numrin e mjeteve të kontrolluara;

b) kategorinë e mjeteve të kontrolluara;

c) vendin e regjistrimit të secilit mjet të kontrolluar;

d) në rastin e kontrolleve më të detajuara, elementet e kontrollit dhe elementet që kanë dështuar, në përputhje me pikën 10, të aneksit IV.

Raporti i parë mbulon periudhën prej dy vjetësh, duke filluar nga 1 janari i vitit pasardhës së vitit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

2. Të dhënat e komunikuara me mjete elektronike transmetohen sipas formatit të procedurave të miratuara nga Komisioni Evropian. Në mungesë të tyre, do të përdoret forma standarde e raportimit e përcaktuar në aneksin V.

KAPITULLI V
AKTET PËRDITËSUESE DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21
Aktet përditësuese

Ministria përgjegjëse për transportin bën përditësimet e këtij akti, sipas akteve të miratuara nga Komisioni Evropian, i autorizuar sipas direktivës përkatëse të miratojë akte të deleguara.

Neni 22
Zbatimi dhe masat administrative

1. Ngarkohen shërbimet e policisë rrugore të ministrisë përgjegjëse për rendin publik, në bashkëpunim me organin kompetent të përcaktuar nga ministria përgjegjëse për transportin, task-forcën e krijuar sipas legjislacionit në fuqi, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Organi kompetent i përcaktuar nga ministria përgjegjëse për transportin, task-forca, e krijuar sipas legjislacionit në fuqi është përgjegjëse vetëm për krijimin e sistemit të vlerësimit të riskut, kryerjen e kontrollit teknik në rrugë, të ngarkesës së lejuar dhe sigurimit të saj, për hartimin e raportit për rastet e kontrollit teknik të detajuar në rrugë të mjetit dhe raportimin sipas formës standarde të raportimit të përcaktuar në aneksin V dhe si pikë kontakti për shkëmbim informacioni.

Masat administrative ndërmerren nga shërbimet e policisë rrugore për shkeljet e konstatuara.

2. Zbatimi i sistemit të vlerësimit të riskut, sipas nenit 6, të fillojë pas 1 viti nga hyrja në fuqi e udhëzimit.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

ANEKSI I
ELEMENTET E SISTEMIT TË VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Sistemi i vlerësimit të rrezikut do të sigurojë bazën për një përzgjedhje të qëllimshme të mjeteve të operuara nga ndërmarrjet me një evidencë të dobët, në lidhje me pajtueshmërinë e kërkesave të gjendjes teknike optimale të mjeteve dhe të mirëmbajtjes së tyre. Merren parasysh rezultatet, si nga kontrollet teknike periodike, ashtu dhe nga kontrollet teknike në rrugë.

Sistemi i vlerësimit të rrezikut do të marrë në konsideratë parametrat e mëposhtëm për përcaktimin e një vlerësimi të rrezikut për ndërmarrjen:

- numri i defekteve;
- serioziteti i defekteve;
- numri i kontrolleve teknike në rrugë ose kontrollet teknike periodike dhe vullnetare të mjetit;
- faktori kohor,

1. Defektet do të peshohen sipas seriozitetit të tyre, duke përdorur faktorët e seriozitetit, si në vijim:

- defekte të rrezikshme = 40;
- defekte të mëdha = 10;
- defekte të vogla = 1.

2. Evoluimi i situatës së mjeteve të një ndërmarrjeje duhet të pasqyrohet duke aplikuar një peshë më të ulët në rezultatet "e vjetra" të inspektimit se sa në ato më të "fundit", duke përdorur faktorët e mëposhtëm:

- viti 1 = 12 muajt e fundit = faktori 3;
- viti 2 = muajt 13–24 = faktori 2;
- viti 3 = muaj 25–36 = faktor 1.

Kjo do të zbatohet vetëm për llogaritjen e vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut.

3. Vlerësimi i rrezikut duhet të llogaritet duke përdorur formulat e mëposhtme,:

a) Formula për vlerësimin e përgjithshëm të rrezikut:

$$RR = \frac{(D_{Y1} \times 3) + (D_{Y2} \times 2) + (D_{Y3} \times 1)}{\#C_{Y1} + \#C_{Y2} + \#C_{Y3}}$$

ku:

RR = Vlera e përgjithshme e vlerësimit të rrezikut;
D_{Yi} = totali për defektet në vitet 1, 2, 3;
D_{Y1} = (#DRr x 40) + (#DM x 10) + (#DV x 1) në vitin 1;
= numri i …;

DRr = defekte të rrezikshme;
DM = defekte të mëdha;
DV = defekte të vogla;
C = kontrolle (kontrolle teknike në rruge ose kontrolle teknike periodike ose vullnetare) në vitet 1, 2, 3.

b) Formula për vlerësimin vjetor të rrezikut:

$$VR = \frac{(\#DRr \times 40) + (\#DM \times 10) + (\#DV \times 1)}{\#C}$$

ku:
VR = vlera vjetore e rrezikut;
#… = numri i …;
DRr = defekte të rrezikshme;
DM = defekte të mëdha;
DV= defekte të vogla;
C = kontrolle (kontrolle teknike në rruge ose kontrolle teknike periodike ose vullnetare).
Rreziku vjetor do të përdoret për të vlerësuar evoluimin e një ndërmarrjeje gjatë viteve.
Klasifikimi i ndërmarrjeve, në bazë të vlerësimit të përgjithshëm të rrezikut duhet të kryhet në mënyrë të tillë, që të arrihet shpërndarja e mëposhtme brenda ndërmarrjeve (mjeteve) të listuara:
- <30% rrezik i ulët;
- 30–80% rrezik i mesëm;
- > 80% rrezik i lartë _____.

ANEKSI II
FUSHËVEPRIMI I INSPEKTIMIT TEKNIK RRUGOR

1. ZONAT E INSPEKTIMIT
0) identifikimi i mjetit;
1) pajisjet e frenimit;
2) sistemi i drejtimit;
3) shikueshmëria;
4) pajisjet e ndriçimit dhe pjesët e sistemit elektrik;
5) boshtet, rrotat, gomat, suspensioni;
6) shasia dhe aksesorët e shasisë;
7) pajisje të tjera;
8) zhurma;
9) teste plotësuese për mjetet e kategorive M2 dhe M3 që mbajnë pasagjerë.
2. KËRKESAT E KONTROLLIT
Elementet që mund të kontrollohen vetëm nga përdorimi i pajisjeve janë shënuar me një E.
Elementet që mund të kontrollohen deri në një farë mase pa përdorimin e pajisjeve janë shënuar me + (E).
Kur një metodë kontrolli klasifikohet si vizuale, kjo do të thotë që, përveç shqyrtimit të elementeve në fjalë, inspektori, gjithashtu, nëse është e përshtatshme, duhet t'i trajtojë ato, të vlerësojë zhurmën e tyre ose të përdorë çdo mjet tjetër të përshtatshëm të inspektimit që nuk përfshin përdorimin e pajisjeve.

Kontrollet teknike në rrugë mund të mbulojnë elementet e listuara në tabelën më poshtë, e cila përfshin metodat e rekomanduara të kontrollit që duhet të përdoren. Asgjë në këtë aneks nuk duhet të pengojë një inspektor të përdorë pajisje shtesë aty ku është e nevojshme, të tilla si pajisjet ngritëse ose gropat.

Kontrollet duhet të kryhen duke përdorur teknikat dhe pajisjet aktualisht në dispozicion, pa përdorimin e veglave për të çmontuar ose për të hequr ndonjë pjesë të mjetit. Kontrolli mund të përfshijë, gjithashtu, një verifikim nëse pjesët dhe komponentët përkatës të mjetit u korrespondojnë kërkesave të sigurisë dhe të mjedisit që ishin në fuqi në kohën e miratimit ose, nëse është e aplikueshme, në kohën e modifikimit (zëvendësimeve).

Kur projektimi i mjetit nuk lejon aplikimin e metodave kontrolluese të përcaktuara në këtë aneks, kontrolli duhet të kryhet në përputhje me metodat e rekomanduara të kontrollit të pranuara nga autoritetet kompetente.

"Arsyet për dështim" nuk zbatohen në rastet kur ato u referohen kërkesave, të cilat nuk janë përshkruar në legjislacionin përkatës për miratimin e mjetit në kohën e regjistrimit të parë ose hyrjes së parë në shërbim ose në kërkesat e modifikimit.

3. PËRMBAJTJA DHE METODAT E TESTIMIT, VLERËSIMI I DEFEKTEVE TË MJETIT

Testi duhet të mbulojë ata artikuj që konsiderohen të nevojshëm dhe të përshtatshëm, duke marrë parasysh, në veçanti, sigurinë e frenave, gomave, rrotave, shasisë dhe zhurmën, si dhe metodat e rekomanduara të renditura në tabelën në vijim.

Për secilin sistem të mjetit dhe përbërësish që i nënshtrohen testimit, vlerësimi i defekteve kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në tabelë, rast pas rasti. Mangësitë që nuk janë të listuara në këtë aneks do të vlerësohen në terma të rreziqeve që ato paraqesin për sigurinë rrugore.

Elementi	**Metoda**	**Arsyet për dështim**	**Vlerësimi i defekteve**		
			I vogël	**I madh**	**I rrezikshëm**
0. IDENTIFIKIMI I MJETIT					
0.1 Targat e regjistrimit (nëse nevojiten sipas kërkesave[1], shih në fund të tabelës)	Inspektimi vizual	a) Targat mungojnë ose janë të vendosura në mënyrë të pasigurt sa mund të bien		X	
		b) Mbishkrimi mungon ose është i palexueshëm		X	
		c) Jo në përputhje me dokumentet e mjetit ose me regjistrat		X	
0.2 Numri i identifikimit të mjetit/ numri i shasisë/numri serial	Inspektimi vizual	a) Mungon ose nuk mund të gjendet		X	
		b) Jo i plotë, i palexueshëm, dukshëm i falsifikuar ose nuk përputhet me dokumentet e mjetit		X	
		c) Dokumentet e mjetit të palexueshme ose gabime materiale	X		
1. SISTEMI I FRENIMIT					
1.1 Gjendja mekanike dhe funksionimi					
1.1.1 Pedali i frenit/ freni dorës	Inspektim vizual i elementeve gjatë vënies në funksion të sistemit të frenimit. Shënim. Mjetet me sistem frenimi të asistuar duhet të inspektohen me motor të fikur.	a) Pedali shtypet me vështirësi		X	
		b) Konsumim i tepërt		X	
1.1.2 Gjendja e pedalit/ frenit të dorës dhe lëvizja për aktivizimin e frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë vënies në funksion të sistemit të frenimit. Shënim. Automjetet me sistem frenimi të asistuar duhet të inspektohen me motor të fikur.	a) Lëvizja e tepërt ose e pamjaftueshme Frenimi nuk kryhet i plotë ose bllokohet		X	X
		b) Pedali nuk kthehet prapa në mënyre korrekte Funksionaliteti i tij është reduktuar	X	X	

		c) Pajisja antirrëshqitje në pedalin e frenave mungon, është e lirshme ose e konsumuar		X	
1.1.3 Pompa e vakumit ose kompresori dhe rezervuarët	Inspektim vizual i elementeve në presion normal pune. Kontroll i kohës së nevojshme për vakumin ose presionin e ajrit për të arritur vlerën e sigurt të punës, si dhe kontroll i funksionimit të pajisjes paralajmëruese, valvulës sigurues të multicirkuitit dhe valvulës së rënies së presionit	a) Presion/vakum i pamjaftueshëm për të asistuar të paktën katër frenime pas aktivizimit të sinjalit paralajmërues (ose treguesi i matësit tregon një vlerë të pasigurt) Të paktën dy frenime pas aktivizimit të sinjalit paralajmërues (ose treguesi i matësit tregon një vlerë të pasigurt)		X	X
		b) Koha e nevojshme për të arritur vlera të sigurta pune të presionit të ajrit në vakum është shumë e gjatë, sipas kërkesave		X	
		c) Valvula siguruese nuk funksionon ose valvula e rënies së presionit		X	
		d) Rrjedhje ajri që shkakton një ulje të dukshme të presionit ose rrjedhje të dëgjueshme ajri		X	
		e) Dëmtimet e jashtme kanë gjasa të ndikojnë në funksionimin e sistemit të frenimit Performanca e duhur e frenit ndihmës nuk është arritur		X	X
1.1.4 Indikatori i presionit të ulët	Kontroll funksional	Keqfunksionim ose indikatori me defekt Presioni i ulët nuk mund të matet	X	X	
1.1.5 Valvula e frenit të dorës	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit	a) Pajisja e kontrollit e thyer, e dëmtuar ose tepër e konsumuar		X	
		b) Pajisja e kontrollit në valvul e pasigurt ose valvula e pasigurt		X	
		c) Lidhjet të lirshme ose rrjedhje në sistem		X	
		d) Funksionim i pakënaqshëm		X	
1.1.6 Aktivizuesi i frenit parkues, leva për aktivizim, mekanizmi bllokues i frenit parkues, freni parkues elektronik	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit	a) Mekanizmi bllokues nuk funksionon në mënyrë korrekte		X	
		b) Konsumim i boshtit ose i mekanizmit bllokues Konsumim i tepërt	X	X	
		c) Lëvizje e tepërt e levës që tregon rregullim jokorrekt		X	
		d) Aktivizuesi mungon, i dëmtuar ose jofunksional		X	
		e) Funksionim jokorrekt, indikatori paralajmërues tregon keqfunksionim		X	
1.1.7 Valvulat e frenimit (valvulat e këmbës, rregullatori i ajrit, valvula shkarkimit)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit	a) Dëmtim i valvulës ose rrjedhje e tepërt ajri Funksionaliteti i saj është reduktuar		X	X
		b) Rrjedhje e tepërt vaji nga kompresori	X		
		c) Valvula e pasigurt ose e montuar jo në mënyrën e duhur		X	

		d) Rrjedhje e lëngut hidraulik Nëse funksionaliteti është reduktuar		X	X
1.1.8 Lidhëset e frenave për rimorkiot (elektrike dhe pneumatike)	Shkëput dhe rilidh lidhëset e sistemit të frenave të mjetit tërheqës dhe rimorkios.	a) Kapaku ose valvula automatike me defekt. Funksionaliteti i saj është reduktuar	X	X	
		b) Kapaku ose valvula të pasigurt ose të montuar jo në mënyrën e duhur Nëse funksionaliteti është reduktuar	X	X	
		c) Rrjedhje e tepër Funksionaliteti i tij është reduktuar		X	X
		d) Funksionim jokorrekt Ndikon në funksionimin e frenave		X	X
1.1.9 Ena e presionit për ruajtjen e energjisë	Inspektim vizual	a) Pak e dëmtuar ose pak e gërryer Shumë e dëmtuar, shumë e gërryer dhe ka rrjedhje	X	X	
		b) Pajisja e zbrazjes nuk funksionon	X		
		c) Ena e pasigurt ose e montuar jo në mënyrën e duhu.		X	
1.1.10 Përforcuesi i forcës së frenimit (servo), cilindri kryesor (sistemet hidraulike)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur	a) Servo-përforcuesi me defekt ose joefektiv Nëse nuk funksionon		X	X
		b) Cilindri kryesor me defekt ndërsa frenat ende funksionojnë Cilindri kryesor me defekt ose me rrjedhje		X	X
		c) Cilindri kryesor i pasigurt ndërsa frenat ende funksionojnë Cilindri kryesor i pasigurt		X	X
		d) Lëng i pamjaftueshëm frenash nën shenjën MIN Lëngu i frenave shumë poshtë shenjës MIN Lëngu i frenave i padukshëm	X	X	X
		e) Kapaku i rezervuarit të cilindrit kryesor mungon	X		
		f) Drita paralajmëruese e lëngut të frenave e ndezur ose me defekt	X		
		g) Funksionim jokorrekt i pajisjes paralajmëruese të nivelit të lëngut të frenave	X		
1.1.11 Tubat e ngurtë të frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur	a) Rrezik i pashmangshëm për prishje apo për thyerje			X
		b) Tubat ose lidhjet rrjedhin (sistemi pneumatik i frenave) Tubat ose lidhjet rrjedhin (sistemi hidraulik i frenave)		X	X

		c) Tubat të dëmtuar ose tepër të gërryer Ndikojnë në funksionimin e frenave lidhur me bllokimin apo me rrezikun nga rrjedhja e menjëhershme		X	X
		d) Tubat të vendosur në mënyrë të gabuar Rrezik për dëmtim	X	X	
1.1.12 Tubat elastikë të frenave	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur	a) Rrezik i pashmangshëm për prishje ose për thyerje			X
		b) Tubat të dëmtuar, me pika fërkimi, të përdredhur ose shumë të shkurtër Tubat të dëmtuar ose me pika fërkimi	X	X	
		c) Tubat apo lidhjet rrjedhin (sistemi pneumatik i frenimit) Tubat apo lidhjet rrjedhin (sistemi hidraulik i frenimit)		X	X
		d) Tubat të fryrë nën presion Kablloja e dëmtuar		X	X
		e) Tubat janë porozë		X	
1.1.13 Tamburet dhe ferrotat	Inspektim vizual	a) Tamburet apo ferrotat tepër të konsumuara (arritje te shenja minimale) Tamburet apo ferrotat tepër të konsumuara (shenja minimale jo e dukshme)		X	X
		b) Tamburet apo ferrotat të përlyera (vajra, graso etj.) Performanca e frenave e reduktuar		X	X
		c) Tamburet apo ferrotat mungojnë ose janë të montuar në mënyrë të gabuar			X
1.1.14 Tamburet e frenave, disqet e frenave	Inspektim vizual	a) Tamburi apo disku të konsumuar Tamburi apo disku tepër të konsumuar, tepër të gërvishtur, të krisur, të pasigurt apo të thyer		X	X
		b) Tamburi apo disku të kontaminuar (vajra, graso etj.) Performanca e frenave e reduktuar		X	X
		c) Tamburi apo disku mungojnë			X
		d) Pllaka mbështetëse e frenave e montuar në mënyrë të pasigurt		X	
1.1.15. Kabllot e frenave, shufrat, levat, lidhjet	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur	a) Kabllot të dëmtuara ose të ngatërruara Performanca e frenimit e reduktuar		X	X
		b) Pjesët tepër të konsumuara ose të gërryera Performanca e frenimit e reduktuar		X	X
		c) Kablloja, leva ose nyja të pasigurt		X	

		d) Mbajtësit e kabllove të dëmtuara		X	
		e) Kufizim i lëvizjes së lirë të sistemit të frenave		X	
		f) Lëvizje pazakontë e levës/lidhjes që tregon vendosje të gabuar ose konsumim të tepërt		X	
1.1.16 Valvula e frenave (cilindri hidraulik i frenave dhe frenat me sustë)	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur	a) Cilindri i krisur ose i dëmtuar Performanca e frenimit e reduktuar		X	X
		b) Cilindri rrjedh Performanca e frenimit e reduktuar		X	X
		c) Cilindri i montuar në mënyrë të pasigurt ose të papërshtatshme Performanca e frenimit e reduktuar		X	X
		d) Cilindri tepër i gërryer Mund të kriset		X	X
		e) Lëvizje e pamjaftueshme ose e tepërt e pistonit punues apo membranës Performanca e frenimit e reduktuar (mungesë e lëvizjes rezervë)		X	X
		e) Mansheta mbrojtëse ndaj pluhurit e dëmtuar Mansheta mbrojtëse mungon ose tepër e dëmtuar	X	X	
1.1.17 Rregullatori i forcës së frenimit	Inspektim vizual i elementeve gjatë funksionimit të sistemit të frenimit, nëse është e mundur	a) Lidhja me defekt		X	
		b) Lidhje e përshtatur në mënyrë jokorrekte		X	
		c) Valvula e bllokuar ose nuk funksionon (funksionimi ABS) Valvula e bllokuar ose nuk funksionon		X	X
		d) Valvula mungon (nëse duhet)			X
		e) Pllaka e të dhënave mungon	X		
		f) Të dhënat janë të palexueshme ose jo në përputhje me kërkesat[1]	X		
1.1.18 Kompensimi automatik dhe indikatori i konsumit të frenave	Inspektim vizual	a) Pajisja për kompensim automatik të konsumit të frenave e dëmtuar, e bllokuar ose me lëvizje jonormale, konsumim të tepërt ose e vendosur në pozicion jokorrekt		X	
		b) Pajisja për kompensim automatik të konsumit të frenave është me defekt		X	
		c) E instaluar ose e zëvendësuar në mënyrë jokorrekte		X	
1.1.19 Sistemi i frenimit me ngadalësim afatgjatë (nëse mjeti është i pajisur ose nëse e	Inspektim vizual	a) Lidhjet ose pajisjet të pasigurta Funksionaliteti i tij është i reduktuar	X	X	

detyrueshme)		b) Sistemi dukshëm me defekt ose mungon		X	
1.1.20 Funksionimi automatik i frenave të rimorkios	Shkëput lidhësen e sistemit të frenave ndërmjet mjetit tërheqës dhe rimorkios	Frenat e rimorkios nuk aktivizohen automatikisht kur lidhësja është e shkëputur			X
1.1.21 Sistemi i frenimit në tërësi	Inspektim vizual	a) Pajisjet e tjera të sistemit (p.sh., pompa kundër ngrirjes, tharësi i ajrit) të dëmtuar nga ana e jashtme ose tepër të gërryer, në mënyrë të tillë sa që ndikojnë negativisht në sistemin e frenimit Performanca e frenave e reduktuar		X	X
		b) Rrjedhje ajri ose e lëndës kundër ngrirjes Funksionaliteti i sistemit i reduktuar	X	X	
		c) Komponentët të montuar në mënyrë të pasigurt ose jokorrekte		X	
		d) Modifikim i pasigurt i komponentëve[3] Performanca e frenave e reduktuar		X	X
1.1.22 Lidhjet për kontrollin (nëse janë të instaluara ose të detyrueshme)	Inspektim vizual	Mungojnë		X	
1.1.23 Sistemi i frenimit nga inercia	Inspektim vizual dhe gjatë funksionimit	Efikasitet e pamjaftueshme		X	
1.2 Efektiviteti dhe performanca e frenit të shërbimit					
1.2.1 Performanca (E)	Gjatë një kontrolli mbi një bankoprovë frenash, aktivizo frenat në mënyrë progresive deri në forcën maksimale të frenimit	a) Forcë e pamjaftueshme frenimi në një ose më shumë rrota Asnjë forcë frenimi në një ose më shumë rrota		X	X
		b) Forca e frenimit në rrotë është më pak se 70% e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks. Ose, në rastin e kontrollit në rrugë, automjeti devijon shumë nga drejtimi i lëvizjes. Forca e frenimit në rrotë është më pak se 50% e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks në rastin e akseve drejtues		X	X
		c) Forca e frenimit nuk ndryshon gradualisht (kapja)		X	
		d) Aktivizim i vonuar i frenave në cilëndo rrotë		X	
		e) Luhatje e tepërt e forcës së frenimit gjatë rrotullimit të plotë të një rrote		X	

1.2.2 Efikasiteti (E)	Kontroll në një bankoprovë frenash ose, nëse kjo nuk mund të përdoret për arsye sigurie, nëpërmjet kontrollit në rrugë, duke përdorur një instrument regjistrues të ngadalësimit[1]	Nuk arrihen standardet minimale si më poshtë[2]: - Kategoritë M1, M2 dhe M3: 50%[3] - Kategoria N1: 45 % - Kategoritë N2 dhe N3: 43%[4] - Kategoritë O3 dhe O4: 40%[5] Të arritura më pak se 50% e vlerave të mësipërme		X	X
1.3 Performanca dhe efektiviteti i frenit ndihmës (të emergjencës) (nëse ka një sistem të veçantë)					
1.3.1 Performanca (E)	Nëse sistemi i frenit ndihmës është i ndarë nga sistemi i frenave të shërbimit, përdoret metoda e specifikuar në 1.2.1	a) Forcë frenimi e pamjaftueshmne në një ose më shumë rrota Asnjë forcë frenimi në një ose më shumë rrota		X	X
		b) Forca e frenimit në cilëndo rrotë është më pak se 70% e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks. Ose, në rastet e kontrollit në rrugë, automjeti devijon shumë nga drejtimi i lëvizjes. Forca frenimit në cilëndo rrotë është më pak se 50% e forcës maksimale të regjistruar në rrotën tjetër në të njëjtin aks, në rast se është aks drejtues.		X	X
